V E N D I M
Nr.583, datë 9.12.1994

PËR KRIJIMIN E SHËRBIMIT TË LËVIZSHËM TELEFONIK

Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të miratohet në parim krijimi i shërbimit të lëvizshëm telefonik shqiptar (mobil).

2. Ministria e Financave dhe Departamenti i Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj të sigurojnë nga buxheti i shtetit fondet e nevojshme që në vitin 1995 dhe 1996 do të përdoren për ngritjen e rrjetit mobil fillimisht në zonën Tiranë-Durrës-Kavajë-Laç-Krujë dhe pastaj në zonat e tjera, sipas përparësive të përcaktuara në aneksin 1.

3. Sistemi i telefonisë së lëvizshme të sigurojë shërbimin telefonik normal edhe në zonat rurale brenda zonës së tij të mbulimit.

4. Për rrjetin telefonik të përdoret standardi teknik numerik panevropian GSM në frekuencën 900 MHz me mundësi kalimi në 1800 MHz.

5. Komisioni Shtetëror i Frekuencave të vërë në dispozicion të këtij shërbimi brenzin 900 MHz.

6. Rrjeti i lëvizshëm, në të gjitha zonat e mbulimit, të kombinohet edhe me një rrjet telefonik fiks “pa tel” dhe një rrjet telefonash publikë që punojnë me karta të parapaguara ose karta krediti.

7.Për realizimin e rrjetit të lëvizshëm telefonik të krijohet Njësia e Implementimit të Projektit Mobil (NIPM) në vartësi të Këshillit të Ministrave.

Kjo njësi do të ketë deri në 16 veta, të cilët do të merren në punë në përputhje me ecurinë e projektit dhe do të paguhen sipas aneksit. 2. Me zhvillimin e projektit NIPM do të konvertohet në një operator të telekomunikacioneve të lëvizshme.

NIPM të sistemohet te mjediset e Qendrës së Studimeve dhe Projektimeve të Automatikës dhe Elektronikës (Instituti i Elektronikës). NIPM të përdorë 60 për qind të sipërfaqes së shfrytëzueshme dhe të mjeteve të zyrave.

NIPM ka këto objektiva kryesorë:

a) Të hartojë specifikimet teknike të rrjetit të lëvizshëm.

b) Të bëjë vlerësimet e trafikut të pritshëm dhe të optimizojë zonat e mbulimit.

c) Të përcaktojë furnizuesin dhe të ndjekë implementimin e rrjetit.

d) Të përcaktojë strukturën e tarifave.

e) Të hartojë gjithë dokumentacionin e nevojshëm për krijimin e operatorit mobil.

8. Për realizimin e rrjetit të lëvizshëm të merret asistencë teknike e huaj, e cila të financohet me fonde të Komunitetit Evropian, organizata ndërkombëtare ose burime të tjera.

9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet aparati i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi